




VS



SHPËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE PËRGJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE

RAPORT MONITORIMI

Mars 2025



QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

AUTOR
DHIMITËR ZGURO

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	3
2.	KUADRI LIGJOR MBI MONITORIMIN	3
2.1.	Detyrimet ligjore mbi takimet, veprimtaritë dhe tubimet elektorale	4
2.2.	Përdorimi i materialeve propagandistike, ngritja dhe veprimtaria në zyrat zgjedhore	5
2.3.	(Sh)përdorimi i burimeve publike	6
2.4.	Rrjetet sociale	7
3.	MONITORIMI I PERIUDHËS NGA 11 JANAR 2025 DERI MË 16 PRILL 2025	8
3.1	Veprimtaritë e denoncuara dhe sfidat lidhur me to	9
3.2	Subjektet e denoncuara	11
3.3	Vendimmarrja e organeve të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve	12
4.	GJETJET KRYESORE	13
5.	REKOMANDIME	14
6.	BIBLIOGRAFIA	15



1. HYRJE

Nga data 11 janar 2025 ka filluar monitorimi i procesit zgjedhor. Ky monitorim, në referim të nenit 92/4, të Kodit Zgjedhor, kufizohet në vëzhgimin e respektimit të atyre detyrimeve që subjektet zgjedhore dhe organet e administratës shtetërore kanë për procesin zgjedhor dhe që janë të verifikueshme lehtësisht. Detyrimet që monitorohen lidhen me organizimin e takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale, përdorimin e materialeve propagandistike dhe ngritjen e zyrave zgjedhore, respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve për veprimtari të caktuara para zgjedhjeve e shpërdorimin e burimeve shtetërore gjatë periudhës së monitorimit, si dhe me monitorimin e mediave online dhe rrjeteve sociale etj.

Duke patur parasysh këto konsiderata, ky raport synon të vlerësojë përputhshmërinë e subjekteve zgjedhore dhe organeve të administratës publike në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni zgjedhor në fuqi, si dhe të identifikojë e më pas të analizojë, shkeljet e evidentuara deri më tani nën dritën e vendimmarrjes së organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke synuar forcimin e integritetit, transparencës dhe drejtësisë në proceset zgjedhore. Për këtë, në përfundim, do të ofrohen dhe rekomandimet përkatëse.

2. KUADRI LIGJOR MBI MONITORIMIN

Më datë 23.7.2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar" (këtu e në vijim "Ligji nr. 101/2020").¹ Sipas Relacionit, miratimi i këtij ligji do të synonte t'i jepte përgjigje problematikave më emergjente të evidentuara nga zbatimi në praktikë i kuadrit ligjor të kohës, si dhe në disa raste, do të adresonte rekomandimet e organizatave ndërkombëtare.² Në këtë kontekst, ligjvënësi vendosi të reformojë dispozitat që lidhen me financimin e zgjedhjeve dhe të fushatës zgjedhore.

Me qëllim mbikëqyrjen e detyrimeve të sanksionuara në lidhje me financimin e fushatës, të cilat synojnë promovimin e transparencës, drejtësisë dhe integritetit në procesin zgjedhor, ligjvënësi reformoi mekanizmin e monitorimit të fushatës.³ Deri para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 101/2020, monitorimi i fushatës kufizohej në monitorimin e zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor për fushatën zgjedhore në mediat audiovizive dhe kryhej nga Bordi i Monitorimit të Medias. Me ndryshimet e reja, monitorimi do të kufizohej në vëzhgimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore në raport me detyrimet ligjore që lidhen me financimin e fushatës,

¹ Ligji nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", Fletorja Zyrtare nr. 143, datë 4.8.2020.

² Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", Tiranë, 2020. Për më shumë shih: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20200706122624Scan%20%282%29.pdf>, aksesuar online më 21.03.2025.

³ Ligji nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", Fletorja Zyrtare nr. 143, datë 4.8.2020.



si dhe respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve mbi forma të caktuara të fushatës dhe shpërdorimit të burimeve publike.⁴

Për vënien në zbatim të këtij mekanizmi, ligjvënësi ka parashikuar se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin për të caktuar, jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, një numër të mjaftueshëm personash që duhet të kryejnë monitorimin, i cili në asnjë rast, nuk duhet t'i ekspozojë monitoruesit ndaj një rreziku të panevojshëm.⁵ Këta monitorues, në mbështetje të gërmës "gj", të pikës 1, të nenit 19, të Kodit Zgjedhor, duhet të trajnohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në lidhje me detyrën e tyre. Objekti dhe perioda e monitorimit, kriteret e përzgjedhjes dhe procedura e emërimit të monitoruesve, si dhe formati i raportimit të monitorimit janë parashikuar në Udhëzimin nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe rregullat për monitorimin" (këtu e në vijim "Udhëzimi nr. 3/2022").

Sipas nenit 3, të Udhëzimit nr. 3/2022, objekti i monitorimit është fushata zgjedhore dhe/ose e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës, duke synuar vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së subjekteve zgjedhore me kërkesat e Kodit Zgjedhor përsa i takon financimit të zgjedhjeve dhe fushatës. Po ashtu, në lidhje me të njëjtat kërkesa ligjore, monitorimi shtrihet edhe mbi veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore ose vendore. Më konkretisht, duke iu referuar pikës 3, të nenit 3, të këtij Udhëzimi, monitorimi kryhet mbi organizimin e takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale, përdorimin e materialeve propagandistike, ngritjen dhe veprimtarinë në zyrat zgjedhore, respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve për veprimtari të caktuara para datës së zgjedhjeve, si dhe përdorimin ose shpërdorimin e burimeve shtetërore gjatë periudhës së monitorimit, monitorimin e mediave online, si dhe të rrjeteve sociale të tilla.

2.1. Detyrimet ligjore mbi takimet, veprimtaritë dhe tubimet elektorale

Sipas nenit 78, të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme. Përfundimisht, me qëllim për të garantuar paanësinë dhe barazinë në procesin zgjedhor, ligjvënësi ka ndaluar zhvillimin e fushatës zgjedhore në institucionet publike. Po ashtu, subjekteve zgjedhore u ndalohet të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj. Nga mënyra sesi është formuluar kjo dispozitë e Kodit Zgjedhor, është e qartë se detyrimet mbi takimet, veprimtaritë dhe tubimet elektorale të parashikuara në të, gjejnë zbatim vetëm mbi fushatën zgjedhore. Për rrjedhojë, duke qenë se deri në datën e hartimit të këtij raporti fushata zgjedhore nuk ka filluar, të dhënat që do të mundësonin vlerësimin apo analizimin e përputhshmërisë me këto detyrime mungojnë.

⁴ Ligji nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", Fletorja Zyrtare nr. 143, datë 4.8.2020.

⁵ Ibid.



2.2. Përdorimi i materialeve propagandistike, ngritja dhe veprimtaria në zyrat zgjedhore

Sipas nenit 79, të Kodit Zgjedhor, kryetarët e bashkive, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, duhet të përcaktojnë vendet publike në territorin e bashkive përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve *"Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore"* (këtu e në vijim *"Udhëzimi nr. 6/2021"*), përveçse duhet t'i njoftohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duhet të publikohet edhe në faqen zyrtare të secilës prej bashkive përkatëse. Nga vëzhgimi i faqeve zyrtare të 61 bashkive, deri në momentin e hartimit të këtij raporti, rezultoi se 28 bashki⁶ nuk kanë plotësuar detyrimin ligjor të publikimit në faqen zyrtare të tyre të vendimit, me të cilin miratohen vendet publike ku mund të afishohen materialet propagandistike. Ndonëse ky numër mund të përkojë me numrin real të bashkive, në territorin e të cilave nuk janë përcaktuar vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike, për shkak të mungesës së të dhënave, nuk mund të konkludohet mbi këtë aspekt. Pavarësisht kësaj, vlen të theksojmë se, moscaktimi i vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike është një fenomen i evidentuar dhe në zgjedhjet e kaluara, ndër të fundit, edhe ato të vitit 2023, ku në 13 bashki nuk u përcaktuan vendet publike.⁷

Krahas pasojave ligjore që vijnë mbi kryetarët e bashkive, mospërcaktimi i vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike sjell pasojë të drejtpërdrejtë edhe mbi procesin zgjedhor në tërësinë e tij. Kështu, moscaktimi i vendeve publike çënon barazinë në zgjedhje ndërmjet subjekteve zgjedhore, duke i dhënë partisë në pushtet një avantazh të padrejtë pasi kjo e fundit, duke patur në dispozicion më shumë burime, ka mundësinë reale për të ndikuar në vullnetin e zgjedhësit, në optikën e të cilit subjektet e tjera zgjedhore nuk do të jenë po aq të pranishme. Një tjetër problematikë lidhet me përdorimin e paligjshëm të hapësirave publike, duke vendosur materiale propagandistike në hapësira publike të ndaluara si: fasadat e godinave të banimit, institucioneve arsimore apo ato të kujdesit shëndetësor, parqe ose pemë.

Përveç materialeve propagandistike, subjektet zgjedhore apo kandidatët e tyre kanë të drejtën që për qëllime të fushatës zgjedhore të hapin mjedise apo zyra zgjedhore. Këto zyra nuk mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, Qendrave të Votimit dhe Vendeve të Numërimit të Votave. Jo më

⁶ Bashkia Bulqizë, Bashkia Dropull, Bashkia Elbasan, Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Kavajë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Klos, Bashkia Konispol, Bashkia Krujë, Bashkia Libohovë, Bashkia Librazhd, Bashkia Lushnjë, Bashkia Malësi e Madhe, Bashkia Maliq, Bashkia Mallakaster, Bashkia Mat, Bashkia Memaliaj, Bashkia Patos, Bashkia Peqin, Bashkia Përmet, Bashkia Poliçan, Bashkia Pukë, Bashkia Pustec, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Shijak, Bashkia Tepelenë, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Vau Dejës.

⁷ Vendimi nr. 466, datë 8.5.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 113, datë 15.05.2023, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.



vonë se 35 ditë përpara datës së zgjedhjeve, subjektet zgjedhore njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vënë në dijeni KQZ-në për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e tyre të sakta.⁸ Për shkak të mungesës së të dhënave, edhe për këtë aspekt nuk mund të arrihet në një përfundim në lidhje me përmbushjen e detyrimit për të njoftuar vendndodhjen e zyrave zgjedhore ose jo.

Për më tepër, materialet propagandistike zgjedhore lejohet të afishohen deri në një distancë prej 5 (pesë) metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve. Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike. Po ashtu, pranë këtyre zyrave, lejohet afishimi i materialeve propagandistike në një distance prej jo më shumë se 5 metrash. Në çdo rast, pavarësisht nga lloji i materialit propagandistik viziv, ai duhet të shoqërohet gjithmonë me shënimin *“‘Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...’ (vijon emri i subjektit zgjedhor).”*⁹ Përndryshe, materialet propaganduese nuk mund të përdoren. Vlen të theksojmë se deri në datën e hartimit të këtij raporti, janë konstatuar 11 raste të shkeljes së dispozitave të sipërcituara dhe për të cilat, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka ngarkuar si subjektin zgjedhor, ashtu edhe Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit me detyrimin për heqjen e materialeve propagandistike.¹⁰

2.3. (Sh)përdorimi i burimeve publike

Në referim të pikës 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, burimet e organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota, nuk mund të përdoren apo vihen në dispozicion të partive politike, koalicioneve apo subjekteve zgjedhore.¹¹ Ky ndalim i përgjithshëm detajohet në ndalime më të posaçme, të cilat, në varësi të rastit, gjejnë zbatim për të gjitha llojet e zgjedhjeve ose vetëm për zgjedhjet e përgjithshme.

Burimet publike përkufizohen qartë në pikën 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, ndërsa forma të detajuara të shpërdorimit të tyre parashikohen në pikën 1.3, të nenit 3, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës*

⁸ Udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve *“Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”*.

⁹ Ligji nr. 101/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”*, Fletorja Zyrtare nr. 143, datë 4.8.2020.

¹⁰ Vendimi nr. 416, datë 7.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 417, datë 7.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 449, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 450, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 451, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 452, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 453, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 454, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 455, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 456, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

¹¹ Ligji nr. 101/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”*, Fletorja Zyrtare nr. 143, datë 4.8.2020.



shtetërore", të ndryshuar (këtu e në vijim si "Vendimi nr. 9/2020").¹² Duke qenë se, në përkufizimin e burimeve publike përfshihen edhe burimet njerëzore, ligjvënësi ka parashikuar se gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura dhe emergjencës.

Për më tepër, Kodi Zgjedhor ka parashikuar se, katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë. Përjashtimisht, një ndalim i tillë nuk gjen zbatim në rast se nisma kushtëzohet nga gjendja e fatkeqësisë natyrore. Sipas Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, kjo dispozitë ndalon vetëm miratimin e akteve nënligjore me karakter normativ,¹³ duke përjashtuar në mënyrë të gabuar, në vlerësimin e autorit të këtij raporti, aktet nënligjore me karakter individual.

Në lidhje me procedurat e dhënies së kontratave publike të koncesionit apo partneritetit publik privat, Komisioni Rregullator ka parashikuar se ndalohet dhënia e atyre kontratave, për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo që nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të vitit zgjedhor.¹⁴

2.4. Rrjetet sociale

Në kontekstin bashkëkohor të komunikimit publik, rrjetet sociale kanë fituar një rol të pazëvendësueshëm në proceset zgjedhore dhe në mënyrën se si qytetarët informohen dhe angazhohen me institucionet dhe subjektet zgjedhore. Ato përbëjnë një mjet të fuqishëm për shpërndarjen e mesazheve politike, mobilizimin e mbështetësve dhe krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë me publikun. Prandaj, në fushatat zgjedhore, përdorimi i rrjeteve sociale është bërë thelbësor për strategjinë e komunikimit të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre.

Për shkak të ndikimit të tyre, rrjetet sociale të institucioneve publike gëzojnë një trajtim të veçantë duke u përfshirë në konceptin e burimeve publike, pasi menaxhohen dhe mirëmbahen me fonde publike. Si platforma zyrtare të

¹² Sipas kësaj pike, shpërdorimi i burimeve publike mund të marrë një nga format vijuese: "(a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve; (b) shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, si dhe të çfarëdolloj tituli pronësie sipas legjislacionit në fuqi në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve; (c) vënien në dispozicion për qëllime zgjedhore të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve të tjera ku shteti zotëron kapital, kuota, aksione dhe/ose emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo administruar; (ç) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim; (d) gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërimet provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura, me përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë; (dh) kontrollet dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatoreve në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale."

¹³ Vendimi nr. 7, datë 19.02.2025, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

¹⁴ Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore", i ndryshuar.



komunikimit, ato shërbejnë për të informuar dhe angazhuar publikun mbi çështje të ndryshme, sipas fushës së përgjegjësisë institucionale. Për rrjedhojë, këto faqe i nënshtrohen të njëjtave rregulla si burimet e tjera publike dhe nuk mund të përdoren për qëllime zgjedhore.

Në këtë kontekst, gjatë zgjedhjeve për organet e njësive të qeverisjes vendore të vitit 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të ndalojë postimet apo ripostimet në rrjetet sociale të një institucioni publik, të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilin personal të drejtuesit të institucionit publik.¹⁵ Me synimin për të përmirësuar dhe adresuar të gjitha shqetësimet e hasura në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike, si dhe për të parandaluar shpërdorimin e tyre dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës katër muaj para zgjedhjeve dhe gjatë fushatës zgjedhore,¹⁶ Komisioneri miratoi Vendimin nr. 240, datë 04.03.2025. Ky vendim synon të nxisë paanshmërinë dhe trajtimin e barabartë të kandidatëve dhe partive politike, duke garantuar kushte të drejta për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Përpara marrjes së këtij Vendimi, Komisioneri kishte vendosur të pushonte hetimin administrativ ndaj 36 institucioneve arsimore¹⁷ dhe 9 institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke vlerësuar se fshirja e postimeve arrinte qëllimin edukues të ligjvënësit.

3. MONITORIMI I PERIUDHËS NGA 11 JANAR 2025 DERI MË 16 PRILL 2025

Deri më datën 16 prill 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar 107 denoncime, për 232 subjekte, në lidhje me shkelje të pretenduara sipas dispozitave të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator. Nga 107 denoncime, hetimi administrativ ka filluar për 82 denoncime, ndërsa për 25 denoncime, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur mosfillimin e hetimit administrativ.

Nga 107 denoncime që janë administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri më datë 16 prill 2025, 73 denoncime janë përcjellë nga Partia Demokratike, 31 denoncime janë përcjellë nga organizatat jofitimprurëse dhe vetëm 3 denoncime janë përcjellë nga sinjalizuesit. Numri i ulët i denoncimeve nga ana e sinjalizuesve është jo vetëm një shenjë e mungesës së informacionit dhe ndërgjegjësimit në lidhje me mekanizmin e sinjalizuesit, por edhe e mungesës së një legjislacioni që garanton një mbrojtje të plotë, të qartë dhe efektive për sinjalizuesit dhe personat e tyre të lidhur.¹⁸



¹⁵ Vendimi nr. 421, datë 03.05.2023, i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.


¹⁶ Zguro Dh., *Shpërdorimi i burimeve publike në periudhën e zgjedhjeve*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Drejtësia, Siguria dhe të Drejtat e Njeriut", Tiranë, 2025 [Dërguar për publikim].

¹⁷ Vendimi nr. 31, datë 24.01.2025, i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

¹⁸ Zguro Dh., *Shpërdorimi i burimeve publike në periudhën e zgjedhjeve*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Drejtësia, Siguria dhe të Drejtat e Njeriut", Tiranë, 2025 [Dërguar për publikim].

3.1 Veprimtaritë e denoncuar dhe sfidat lidhur me to

Përgjatë këtij nënkapitulli do të trajtohet tipologjia e veprimtarive të denoncuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si shkelje të mundshme të dispozitave të Kodit Zgjedhor, me qëllim analizimin e natyrës së veprimeve apo mosveprimeve për të cilat është pretenduar shkelja, ashtu edhe të veprimtarisë administrative të organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Tab.1. Denoncimet sipas objektit të tyre deri më datë 16 prill 2025.

Nisur nga tabela e mësipërme që pasqyron tipologjinë apo natyrën e shkeljes së pretenduar dhe numrin për secilin rast, konstatohet një shqetësim i shtuar në këto zgjedhje në lidhje me përdorimin e akteve ligjore ose nënligjore si një mënyrë që një parti politike e caktuar të përfitojë mbështetje nga zgjedhësit, duke krijuar kështu avantazhe të padrejta në procesin zgjedhor. Rritja e denoncimeve për këtë kategori të veprimeve, në këndvështrimin e autorit të këtij punimi, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me kohën, kur fillon të veprojë ndalimi i parashikuar në pikën 4, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor, sepse sipas ligjvënësist, ndalimi i parashikuar në këtë pikë vepron vetëm gjatë zgjedhjeve të përgjithshme.

Denoncimi i parë që kishte për objekt një akt normativ që krijonte përfitime në lidhje me kategori të caktuara të popullsisë për zgjedhjet e vitit 2025, ishte denoncimi me nr. 4.¹⁹ Ndonëse denoncimi lidhej me miratimin e një projektligji, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nisur nga qëllimi i denoncimit, e zgjeroi objektin e hetimit administrativ edhe mbi projektligjet që ishin në kalendarin dhe programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë për periudhën nga data 20 janar deri më datën 28 shkurt 2025. Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi se dy projektligje, më konkretisht projektligji “Për paketën e maleve” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92, datë 24.07.2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, kishin ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin ekonomik dhe atë tregtar, duke krijuar kështu premisa për cënimin e barazisë ndërmjet aktorëve ekonomikë në prag të

¹⁹ Vendimi nr. 83, datë 11.02.2025, i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

zgjedhjeve dhe për krijimin e perceptimit të përdorimit të instrumenteve ligjore për përfitim elektoral. Për rrjedhojë, Komisioneri vendosi t'i rekomandonte Kuvendit të Shqipërisë që të mos i përfshinte për shqyrtim këto projektligje në seancë plenare.²⁰

Qëndrimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në rastin e sipërcituar u gjet si i pambështetur në ligj nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.²¹ Sipas Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve: *"Propozimi, miratimi apo nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore ndalohej jo kur ka lidhje me fusha apo sektorë të caktuar, as kur prek politikën sektoriale, por kur sjell përfitime për kategori të caktuara të popullsisë."*²² Në vijim, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve u shpreh se, asnjë prej projektligjeve nuk sillte në vetvete përfitime për kategori të caktuara të popullsisë, pasi ndërsa njëri prej projektligjeve ishte akt kuadër dhe kategoria e popullsisë që përfitonte prej tij ishte e papërcaktueshme, projektligji tjetër synonte rregullimin e tregut. Megjithatë, në vlerësimin e autorit të këtij punimi, qëndrimi i Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve është i pabazuar në ligj. Kjo pasi kur ligji referon tek kategori të caktuara të popullsisë nuk kërkon që këto të fundit të jenë të përcaktuara në mënyrë konkrete, por vetëm që kategoria e popullsisë të ekzistojë në mënyrë abstrakte si mundësi ligjore për t'u përcaktuar.

Një tjetër fenomen shqetësues që evidentohet nga të dhënat është përdorimi i rrjeteve sociale zyrtare të institucioneve shtetërore për qëllime zgjedhore. Numri i lartë i denoncimeve në këtë drejtim dëshmon për një përdorim të gjerë të platformave të komunikimit zyrtar si mjete propagandistike në mbështetje të një subjekti të caktuar zgjedhor apo kandidati, në kundërshtim të hapur me detyrimin për paanësi dhe barazi zgjedhore. Një nga rastet më flagrante ishte ai kur Kuvendi i Shqipërisë postoi në faqen e tij zyrtare në Facebook një imazh, në përmbajtjen e të cilit, gjendej një dorë e hapur që tregonte numrin 5 (pesë) dhe që bënte thirrje për votimin në favor të Partisë Socialiste dhe Edi Ramës.²³ Megjithatë, në të gjitha rastet e (sh)përdorimit të rrjeteve sociale, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur pushimin e hetimit administrativ. Në këtë përfundim, Komisioneri ka arritur pasi ka konstatuar se postimet, ripostimet dhe pëlqimet, me karakter politik janë fshirë nga rrjetet sociale të institucioneve,²⁴ duke e vlerësuar qëllimin e ligjvënësit, të arritur, pasi dispozitat e nenit 91, të Kodit Zgjedhor, në vlerësimin e organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë qëllime informuese dhe edukuese.

Po ashtu, edhe fenomeni i shpërdorimit të burimeve publike, përmes vënies në dispozicion të aseteve institucionale për interesat e partive politike, kandidatëve apo koalicioneve, vijon të mbetet një praktikë problematike dhe e përhapur. Shifrat dhe rastet e denoncuar evidentojnë jo vetëm mangësi në zbatimin e standardeve zgjedhore, por edhe mungesë të mekanizmave efektivë të parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre praktikave, duke cënuar kështu integritetin e procesit zgjedhor.

Në këtë drejtim, evidentohet si shqetësues qëndrimi i mbajtur nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në lidhje me periudhën kur fillon zbatimi i

²⁰ Vendimi nr. 83, datë 11.02.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

²¹ Vendimi nr. 7, datë 19.02.2025, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

²² Ibid.

²³ Për më shumë: <https://shqiptaria.com/lajm/postuan-ne-facebook-foto-me-numrin-5-per-te-votuar-ps-kuvendi-stafi-dhe-rrjetet-tona-nuk-perfshihen-ne-fushate-alibeg-shkelje-zgjedhore>, aksesuar online më 16.04.2025.

²⁴ Vendimi nr. 31, datë 24.01.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.



ndalimit të vënies në dispozicion të burimeve shtetërore. Sipas shumicës së anëtarëve të këtij Komisioni, në mungesë të përcaktimit ligjor të afatit kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, është e pamundur për që veprimtaritë në lidhje me shpërdorimin e burimeve publike të cilësohen si "veprimtari të ndaluara", përveçse pasi të ketë filluar "periudha e fushatës zgjedhore".²⁵ Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim, së pari, me konceptin e "zgjedhjeve", i cili është një koncept shumë më i gjerë sesa koncepti i "fushatës zgjedhore". Kjo pasi zgjedhjet përfshijnë tërësinë e veprimeve që kryhen në funksion të ushtrimit të të drejtës së votës nga zgjedhësit në datën e dekretuar nga Presidenti i Republikës. Së dyti, edhe po t'i referohemi Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, qëllimi i vënies në dispozicion të burimeve publike lidhet me zgjedhjet dhe jo me fushatën në veçanti, si pjesë përbërëse e procesit zgjedhor. Për më tepër, që sikundër vetë Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pranon, veprimtaritë me natyrë elektorale mund të shtrihen dhe para periudhës së fushatës zgjedhore.²⁶

Një tjetër rast që paraqitet me interes për efekt të monitorimit të veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi ndalimin e shpërdorimit të burimeve publike, është ai i shpërndarjes së certifikatave të pronësisë për banorët e zonës së "5 Majit" në Tiranë nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj.²⁷ Nga hetimi administrativ, rezultoi në fakt, ndonëse nga sa ishte propaganduar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe mediat, nuk ishin shpërndarë certifikata pronësie, por kontratat e marrjes paraprake në dorëzim të objektit (certifikatat e përdorimit).²⁸ Për këtë shkak, Komisioneri vendosi të pushojë hetimin administrativ duke mos gjetur shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Në gjurmën "b", të pikës 1.3, të nenit 3, të vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, shpërndarja në veprimtari publike e akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë dhe çfarëdolloj titulli pronësie konsiderohet si veprimtari e ndaluar. Megjithatë Komisioneri vlerësoi se certifikatat e përdorimit nuk përfshiheshin në ndalimin e sipërcituar, pavarësisht se këto certifikata, në referim të pikës 8, të nenit 27, të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar, përbëjnë dokument për regjistrimin e pronës në regjistrat publik.

3.2 Subjektet e denoncuar

Në lidhje me subjektet e denoncuar, sikundërse jemi shprehur dhe më herët, denoncuesit kanë denoncuar 232 subjekte të ndryshme, të ndarë në kategori sipas funksioneve përkatëse. Të dhënat e paraqitura, sipas të cilave janë administruar denoncime për 232 subjekte që mbajnë funksione të ndryshme publike dhe politike, dëshmojnë për një situatë të thelluar të mungesës së integritetit në administrimin publik dhe në nivelet më të larta të qeverisjes në Shqipëri.


²⁵ Vendimi nr. 45, datë 04.04.2023, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve; Vendimi nr. 54, datë 11.04.2023, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

²⁶ Vendimi nr. 22, datë 10.04.2025, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

²⁷ Për më shumë shih: <https://shqiptaria.com/lajm/veliaj-iej-certifikatat-e-pronesise-per-familjet-e-5-majit-i-vendosur-ti-coj-punet-deri-ne-fund/>, aksesuar online më 16.04.2025.

²⁸ Vendimi nr. 373, datë 28.03.2025, i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.





Tab.2. Denoncimet sipas subjektit të denoncuar deri më datë 1 prill 2025.

Numri i denoncimeve ndaj titullarëve të institucioneve, që përbëjnë më shumë se gjysmën e rasteve (113), tregon për një përhapje të gjerë të shkeljeve të mundshme jo vetëm në aparatin qendror të qeverisjes, por edhe në administratën publike, e cila e sheh shpërdorimin e burimeve publike si diçka të zakonshme, duke treguar kështu për ekzistencën e një kulture ku asetet publike perceptohen si mjete në funksion të interesave personale ose politike.

Po ashtu, numri i lartë i denoncimeve kundrejt kryetarëve të bashkive dhe ministrave, tregon qartazi ekzistencën e problemit të shpërdorimit të burimeve publike dhe shkallën masive të përhapjes së këtij fenomeni. Ky fenomen është veçanërisht më i përhapur në rastin e bashkive, ku burimet publike janë më pranë qytetarëve.

Për më tepër, konstatimi i një kulture të shpërdorimit të burimeve publike si një fenomen “i zakonshëm” tregon se çështja nuk ka të bëjë vetëm me aspekte të legjislacionit apo individë të veçantë, por me mungesën e një mekanizmi kontrolli efektiv dhe mungesën e vullnetit politik për të parandaluar shpërdorimin e burimeve publike.

3.3 Vendimmarrja e organeve të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve

Nga 107 denoncime për të cilat është filluar hetimi administrativ, ai është përfunduar vetëm për 45 denoncime. Nga këto denoncime, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur pushimin e hetimit administrativ për 41 raste, ndërsa i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative të gjobës vetëm për tre raste. Kjo shifër është jashtëzakonisht e ulët në raport me numrin e përgjithshëm të hetimeve të filluara apo denoncimeve të mbërritura. Edhe pse është e kuptueshme që jo çdo denoncim përmbush kriteret ligjore për ndëshkim, numri i madh i pushimeve në raport me masat e propozuara krijon dyshime mbi mënyrën e interpretimit të dispozitave ligjore nga ana e Komisionerit Shtetëror të

Zgjedhjeve. Përpos kësaj, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në një rast ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të mos miratojë dy projektligje, megjithatë, ky rekomandim u shfuqizua nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.²⁹

Kundër vendimeve të Komisionerit Shtetërorit të Zgjedhjeve janë administruar gjashtë kërkesa ankimore. Deri në datën e hartimit të këtij raporti, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vendosur të shfuqizojë vendimet e Komisionerit në të tre raste dhe të pushojë hetimin administrativ në një rast. Nga ana tjetër, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vendosur të rrëzojë një kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni.³⁰

4. GJETJET KRYESORE

- Zbatimi i Ligjit nr. 101/2020 mbetet problematik, pavarësisht se përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës dhe integritetit zgjedhor.
- Mungesa e transparencës nga ana e bashkive është shqetësuese, me 28 bashki që nuk kanë publikuar vendime mbi hapësirat për afishimin e materialeve zgjedhore, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Zgjedhor.
- Përdorimi i akteve normative për përfitime elektorale, ku u evidentuan denoncime për miratimin e projektligjeve me ndikim në elektorat (p.sh. "Për paketën e maleve" dhe ndryshimet në ligjin për TVSH). Komisioneri kërkoi mospërfshirjen e tyre në seancë plenare, por KAS e rrëzoi qëndrimin, duke argumentuar se përfitimet nuk ishin për kategori të identifikueshme të popullsisë.
- Keqpërdorimi i rrjeteve sociale institucionale, ku u raportuan denoncime të shumta për përdorim politik të faqeve zyrtare (p.sh. postimi i Kuvendit me thirrje për votë për PS). Megjithatë, KQZ pushoi hetimet, duke argumentuar se pas fshirjes së postimeve, qëllimi i ligjit ishte përmbushur.
- Rasti i "5 Majit" në Tiranë, ku shpërndarja publike e certifikatave të pronësisë nga Kryetari i Bashkisë Tiranë u konsiderua nga Komisioneri si e lejuar, megjithëse këto certifikata përdoren për regjistrim prone dhe mund të përfshihen në ndalimin ligjor.
- Mungesë veprimesh ndëshkuese nga KQZ, ku nga 107 hetime të nisura, vetëm në 3 raste është propozuar gjykitje. 41 janë pushuar, duke ngritur dyshime për interpretim të ngushtë apo të njëanshëm të ligjit.
- Numri i ulët i sinjalizimeve nga individët, ku janë raportuar vetëm 3 denoncime të bëra nga sinjalizues, ç'ka tregon mungesë ndërgjegjësimi dhe mungesë mbrojtjeje efektive ligjore për sinjalizuesit në Shqipëri.
- Denoncimet kanë prekur 232 subjekte, ku mbi 113 janë titullarë institucionesh, duke sinjalizuar një përhapje sistematike të shkeljeve dhe një kulturë të pranuar të përdorimit të burimeve shtetërore për përfitime politike.



²⁹ Vendimi nr. 7, datë 19.02.2025, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

³⁰ Vendimi nr. 22, datë 10.04.2025, i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

5. REKOMANDIME

- **Zbatimi i ndalimeve për përdorimin e burimeve publike duhet të fillojë menjëherë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve, jo vetëm gjatë fushatës zyrtare.**

Interpretimi aktual i KAS që kufizon ndalimet vetëm për periudhën zyrtare të fushatës cënon thelbin e parimeve të barazisë dhe integritetit të zgjedhjeve. Për një garë të drejtë, ndalimi i përdorimit të burimeve publike (si fondet, asetet dhe autoriteti institucional) për qëllime elektorale duhet të vlejë për të gjithë periudhën zgjedhore, nga dekretimi i zgjedhjeve deri në ditën e votimit.

- **KQZ dhe Komisioneri duhet të përforcojnë kapacitetet për hetim dhe ndëshkim efektiv të shkeljeve.**

Numri i ulët i masave ndëshkimore në raport me denoncimet e shumta tregon për nevojën e rritjes së pavarësisë, kapaciteteve analitike dhe burimeve njerëzore brenda institucionit të Komisionerit. Një mekanizëm i fortë hetimor dhe ndëshkues do të frenonte praktikën abuzive dhe do të rriste besimin publik në procesin zgjedhor.

- **Duhet të përcaktohen qartë në ligj rastet e ndaluara të përdorimit të rrjeteve sociale institucionale gjatë periudhës zgjedhore.**

Ligji aktual nuk parashikon qartë ndalimin e propagandës elektorale në platformat dixhitale zyrtare të institucioneve publike. Kjo krijon një hapësirë abuzimi dhe paqartësie. Rregullat duhet të jenë të qarta dhe të zbatueshme, duke përfshirë sanksione të përcaktuara për çdo përdorim të hapur apo të tërthortë të komunikimit institucional për përfitim elektorale.

- **Të forcohet mbrojtja dhe promovimi i sinjalizuesve që denoncojnë abuzimet me burimet publike.**

Fakti që vetëm 3 denoncime janë bërë nga individë tregon për mungesë besimi në sistem dhe frikë nga pasojat. Është e domosdoshme të krijohen mekanizma të sigurt e konfidencialë për raportim dhe të garantohet mbrojtja ligjore dhe fizike e sinjalizuesve, në përputhje me direktivat më të fundit të BE-së mbi sinjalizimin e korrupsionit.



6. BIBLIOGRAFIA

- <https://shqiptarja.com/lajm/postuan-ne-facebook-foto-me-numrin-5-per-te-votuar-ps-kuvendi-stafi-dhe-rrijetet-tona-nuk-perfshihen-ne-fushate-alibeaj-shkelje-zgjedhore>, aksesuar online më 16.04.2025.
- <https://shqiptarja.com/lajm/veliaj-jep-certifikatat-e-pronesise-per-familjet-e-5-majit-i-vendosur-ti-coj-punet-deri-ne-fund>, aksesuar online më 16.04.2025.
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Relacion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", Tiranë, 2020.
- Ligji nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", Fletorja Zyrtare nr. 143, datë 4.8.2020.
- Udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".
- Vendimi nr. 113, datë 15.05.2023, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
- Vendimi nr. 22, datë 10.04.2025, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
- Vendimi nr. 31, datë 24.01.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 373, datë 28.03.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 416, datë 7.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 417, datë 7.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 421, datë 03.05.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 449, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 45, datë 04.04.2023, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
- Vendimi nr. 450, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 451, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 452, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 453, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 454, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 455, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 456, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 457, datë 8.4.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 466, datë 8.5.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 54, datë 11.04.2023, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
- Vendimi nr. 7, datë 19.02.2025, i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
- Vendimi nr. 83, datë 11.02.2025, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore", i ndryshuar.
- Zguro Dh., Shpërdorimi i burimeve publike në periudhën e zgjedhjeve, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Drejtësia, Siguria dhe të Drejtat e Njeriut", Tiranë, 2025 [Dërguar për publikim].



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NUZDAM
TË DËMOKRACIËN
PËR
TË MËN DËMOKRACIËN

EUROPEAN UNION • UNITED STATES OF AMERICA

www.qeverisja.qq.com.al